



## **KËRKESE PËR OFERTË**

**Dizajnimi dhe zhvillimi i hulumtimit për matjen e opinionit publik në Kosovë**

**“Corruption Scan 2016”**



## KËRKESË PËR OFERTË

**TITULLI: “Corruption Scan”**

### ***DIZAJNIMI DHE ZHVILLIMI I HULUMTIMIT PËR MATJEN E OPINIONIT PUBLIK NË KOSOVË***

Lëvizja FOL fton kompanitë për shërbime profesionale të paraqesin ofertat e tyre për zhvillimin e hulumtimit për matjen e opinionit publik në Kosovë sipas specifikave të paraqitura në këtë kërkesë.

Data e fundit për dorëzimin e ofertës së kompletuar është 22 Korrik 2016 në ora 17:00. Oferta mund të dëgohet në email adresën [info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org) me titullin “Ofertë për Lëvizja FOL” apo në zarf të mbyllur me mbishkrimin “Ofertë për shërbime të realizimit të anketimit”. Zarfi mund të dorëzohet në Zyren e Lëvizjes FOL, me adresë në Rruga Andrea GRopa no. 35 Prishtinë 10000. Ofertat e dorëzuara pas 22 Korrikut nuk do të shqyrtohen.

Të gjitha informatat në lidhje me këtë shpallje mund të mirren në email adresën: [info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org) ose në numrin e telefonit +386(0) 49 131 542.

Specifikacionet e kësaj kërkesë mund ti gjeni në këtë dokument.

## **PËRMBAJTJA:**

Hyrje: .....	4
Përshkrimi i shërbimit .....	5
Metodogjia e hulumtimit .....	5
Kërkesat për kontraktor për sigurimin e realizimit të pyetësorit.....	5
Periudha e performancës .....	5
Kontrolli i cilësisë nga kontraktuesit dhe plani i sigurimit të cilësisë së mbikqyrjes .....	6
Plani i punës: .....	6
Instruksonet e ofertimit: .....	7

## HYRJE:

Lëvizja FOL është duke implementuar projektin “Krijimi i indeksit Kundër Korrupsionit në Kosovë nëpërmjet realizimit të hulumtimeve për matjen e opinionit publik në Kosovë për Integritetin e Institucioneve Publike dhe nivelin e korrupsionit”. Projekti synon të bëjë matjen e përvojave dhe perceptimeve të qytetarëve në raport me Korrupsionin në Kosovë”. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Holandeze në Kosovë. Në vazhden e hulumtimeve të opinionit publik mbi perceptimin dhe përvojat e tyre për korrupsionin në Kosovë, FOL planifikon të zhvillojë hulumtimin e dytë “Corruption Scan”.

Sic jeni të informuar, Lëvizja FOL, përmes hulumtimit të opinionit publik të quajtur [CorruptionSCAN](#), dëshiron të kontribuojë në përmirësimin e institucioneve publike si dhe legjitimitetin e tyre në raport me qytetarët.

Ky sondazh do të analizojnë nivelin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike të Republikës së Kosovës. Në mënyrë të veçantë, ky hulumtim do të analizoj perceptimin e qytetarëve në lidhje me nivelin e korrupsionit në vend.

Temat që do të përfshihen në këtë hulumtim janë:

- Njohuritë dhe përvojat e qytetarëve për praninë e korrupsionit në institucione publike.
- Sa është e pranueshme sjellja korruptive nga qytetarët e Kosovës.
- Hulumtimi do të analizojë nëse për ndonjë shërbim publik, qytetarë duhet të ofrojnë rryshfet apo dhurata të tjera, direkt ose indirekt, apo edhe të përdorin lidhjet e tyre në punësim në sektorin publik.
- Hulumtimi do të analizojnë perceptimin e qytetarëve në lidhje me nivelin e korrupsionit në Kosovë gjatë tre viteve të fundit nëse ka shënuar rritje, ka mbetur i njëjtë apo është ulur.
- Qytetarët do të pyeten nëse ata u përballën me veprime korruptive, nëse po, a janë raportuar në institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.



## **PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT**

FOL fton të gjitha kompanitë për propozim të shërbimit për realizimin e këtij hulumtimi me specifikacionet dhe planin e punës si më poshtë.

## **METODOGJIA E HULUMTIMIT**

Ky hulumtim, do të zhvillohet në 38 komuna të Kosovës duke përdorur metodat sasore dhe cilësore të hulumtimit. Në këtë drejtim, popullsia e përgjithshme do të ndahen në grupe më të vogla. Shtresa e parë konsiston në përkatësinë etnike, ku janë vendosur tre nën-grupe të ndryshme. Shtresa e dytë do të bazohet në vendbanimin; për secilën komunë mostra do të shtrihet në zonat urbane dhe rurale, në bazë të statistikave zyrtare të ASK-së. Shtresa e tretë do të bazohet në numrin e të intervistuarve të kryera në çdo vendbanim (pika duke filluar). Niveli i besimit e anketimit duhet të jetë në 95% me një diferencë të gabimit në + -3.1%.

Hulumtimi duhet të përfshijë **1200 qytetarë** të Kosovës; rreth 93% e tyre të përkatësisë etnike Shqiptare, 4% Serbë, 1.2% Ashkali, 0.5% Goran, 0.5% Turq, 0.4% Boshnjakë dhe 0.4% Romë.

Kontraktorët duhet të realizojnë edhe **100 Intervista** të thella si dhe mbajtjen dhe organizimin e **6 fokus grupeve** me grupet e synuara të interesit.

## **KËRKESAT PËR KONTRAKTOR PËR SIGURIMIN E REALIZIMIT TË PYETËSORIT**

Kontraktori obligohet që pyetësin ta testoj para fillimit të anketimit me qëllim të identifikimit të ndonjë problemi eventual si dhe trajnimin e intervistuesve mbi pyetësin.

Përzgjedhja e të intervistuarve duhet të bëhet përmes tri fazave të mëposhtme: Faza e parë: zgjedhja e vendbanimit me anë të një teknike sistematike në këmbë. FAZA E DYTË: me përjashtim, identifikimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë. FAZA E TRETË: kryerjen e intervistave ballë për ballë.

Kontraktori do të punojë ngushtë me stafin e FOL për të zhvilluar dhe dizajnuar instrumentet e hulumtimit. Për çdo aktivitet të synuar, kontraktuesi duhet të zhvillojë një plan, për hartimin e anketës, zbatimin, mbledhjen e të dhënave, dhe monitorimin e realizimit të pyetësit. Kontraktuesi mund të jap rekomandime për të optimizuar procesin për ndonjë ngecje eventuale në realizimin e pyetësit. Miratimi duhet të jetë në bashkëpunim të ngushtë me stafin e FOL.

Kontraktori do të sigurojë një plan për analizë në kohë reale të rezultateve ku përfshihen shifrat e rezultateve teknike të hulumtimit.

## **PERIUDHA E PERFORMANCËS**

Realizimi i këtij projekti parashikohet të jetë nga data 28 Korrik - 20 Shtator 2016.

## KONTROLLI I CILËSISË NGA KONTRAKTUESIT DHE PLANI I SIGURIMIT TË CILËSISË SË MBIQYRJES

- Kontraktuesi duhet të përshkruajë procedurat e tyre që i kanë për të monitoruar cilësinë e Shërbimeve.
- Planin e mbikqyrjes së kualitetit.
- Metodën për monitorimin, identifikimin dhe korrigjimin e mangësive në cilësinë e shërbimit.
- Kontraktuesi duhet të përshkruajë procedurat e tyre për të siguruar integritetin e të dhënave mbi anketimin dhe hulumtimin.

### PLANI I PUNËS:

Aktiviteti	Afati Kohor	Metoda
Hartimi dhe finalizimi i pyetësorit	28 Korrik - 04 Gusht	Hartimi dhe finalizimi i pyetësorit (së bashku me FOL)
Testimi dhe finalizimi i pyetësorit	05 - 06 Gusht	Kontraktuesi - në bashkëpunim me FOL
Zhvillimi i databazës	06-08 Gusht	
Trajnimi i anketuesve	08-09 Gusht	
Administrimi dhe zhvillim i pyetësorit	10 - 15 Gusht	
Kontrolli i kualitetit të anketimit	10-15 Gusht	Kontraktuesi - në bashkëpunim me FOL
Pastrimi i databazës	16 Gusht	
Hartimi i raportit kuantitativ mbi anketimin	16-20 Gusht	
Organizimi i 6 fokus grupeve	16-24 Gusht	Hartimi i udhëzuesit për FGD, rekrutimin e pjesëmarrësve, qiranë e hapësirës, pagesat e kompensimit, pije, regjistrimet audio dhe transkriptet.
Hartimi i raportit mbi të gjeturat e fokus grupit	24-28 Gusht	
Realizimi dhe administrimi i intervistave të thella	25-28 Gusht	Kontraktuesi - në bashkëpunim me FOL
Hartimi i raportit mbi të gjeturat e intervistave të thella	28-30 Gusht	

Shkrimi i raportit përfundimtar “Corruption Scan”	01 Shtator - 20 Shtator	
Përkthimi i raportit në gjuhën Angleze/Serbe	20-25 Shtator	

**INSTRUKSIONET E OFERTIMIT:**

Formati: MS Office apo Adobe PDF.

**Letra hyrëse. Ofertuesi duhet të përfshijë një letër hyrëse që përmban informacionin e mëposhtëm:**

1. Emri dhe adresa e ofertuesit.
2. Email adresën zyrtare të kompanisë dhe uebsite.
3. Numrin e regjistrimit të biznesit.
4. Numrin Fiskal / TVSH.

**Dokumentet shtesë obligative:**

1. Çertifikatën e regjistrimit të biznesit.
2. Çertifikatën e numrit fiskal / TVSH-së.
5. Një deklaratë që specifikon zotueshmërinë e realizimit të marrëveshjes me të gjitha termat, kushtet dhe dispozitat të përfshira në kërkesë dhe pranimin e çdo amendamenti të specifikave varësisht nga rekomandimet dhe bashkëpunimi.
6. Referenca mbi kryerjen e punëve të ngjashme të dëshmuara.

**PROPOZIMIN TEKNIK:**

Ofertuesi duhet të demonstrojë dhe të përshkruajë propozimin e tyre për përmbushjen e kërkesave nga FOL. Jo më shumë se 5 faqe. Ofertuesi mund të paraqet afatin e vet kohor të implementimit të aktiviteteve të parapara, afat i cili mund të jetë më i shkurtër por që nuk duhet të tejkalojë afatin e përcaktuar në këtë kërkesë.

**PROPOZIMIN FINANCIAR:**

Ofertuesi duhet të paraqesë ofertën financiare për secilin aktivitet duke përfshirë çmimin me TVSH. *Shih tabelën.*

Nr.	Aktiviteti:	Njësia / Ditë orë / Anketë	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi Total
1					
Total					

## **QASJA MENAXHIMIT:**

Ofertuesi duhet të demonstrojë se ka aftësinë për të menaxhuar dhe kontrolluar realizimin e suksesshëm të pyetësorit, duke përfshirë burimet njerëzore dhe teknike. Qasjen e arritjes së cilësisë, kontrollet e brendshme dhe të personelit. Ky seksion duhet të jetë jo më shumë se 5 faqe.

## **TËRHEQJA APO MODIFIKIMI I OFERTAVE**

Ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin propozimin e tyre me shkrim ose me njoftim elektronik, para mbylljes së afatit për pranimin e propozimeve.

## **VONESA NË DORËZIMIN E OFERTAVE**

Ofertat e dorëzuara pas përfundimit të afatit nuk do të shqyrtohen.

## **FAKTORËT E VLERËSIMIT**

Fituesi do të përzgjidhet ai ofertues i cili propozon vlerën më të mirë siç përcaktohet nga procedurat përshkruara në seksionet e mëparshme.

FOL rezervon të drejtën të refuzojë propozimet që janë tepër të ulëta apo të lartë në çmim. Çmimi do të vlerësohet në bazë të kostos reale.

FOL do të përcaktojë pranueshmërinë e ofertuesit duke vlerësuar pajtueshmërinë e ofertuesit me kushtet e kësaj kërkesë për ofertë

Konkurrenca është e hapur për çdo ofertues pavarësisht madhësis së biznesit, por pikë do të jepen më shumë ofertuesve të cilët kanë përvoja paraprake në këtë fushëveprimtari.

### **Faktorët e vlerësimit**

<b>Përshkrimi i faktorit</b>	<b>Vlerësimi i faktorit</b>
Propozimi teknik	30%
Qasja e menaxhimit	20%
Përvoja e kaluar	10%
Propozimi financiar	30%
Plani i implementimit	10%

## **PËRZGJEDHJA E FITUESIT**

FOL, pas marrjes së propozimeve , rezervon të drejtën për të njoftuar të gjithë ofruesve mbi pranueshmërinë teknike të propozimeve të caktuara. 5 (pesë) ditë pas përmbylljes së ofertës FOL do të njoftojë të gjithë ofertuesit mbi pranueshmërinë apo jo pranueshmërinë e ofertës së tyre.

## **AFATI I APLIKIMIT**

Data e fundit për dorëzimin e ofertës së kompletuar është 22 Korrik 2016 në ora 17:00. Oferta mund të dëgohet në email adresën [info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org) me titullin “Ofertë për Lëvizja FOL” apo në zarf të mbyllur me mbishkrimin “Ofertë për shërbime të realizimit të anketimit”. Zarfi mund të dorëzohet në Zyren e Lëvizjes FOL, me adresë në Rruga Andrea GRopa no. 35 Prishtinë 10000. Ofertat e dorëzuara pas 22 Korrikut nuk do të shqyrtohen.